



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:034818

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874254

KPPP.nr.213/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Europrinty” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “Ymer Aliu”, Nr. 70, Lagjja Kalabria, me NUI: 810444878, kundër debitorit Komuna e Klinës, me seli në Klinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.937/23 të datës 05.12.2023 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Klinës, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.937/23 i datës 05.12.2023, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Europrinty” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.937/23 të datës 05.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës nr. 10431-210-001-20 të datës 10.12.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur të ia paguaj kreditorit shumën prej 1,121.00 €, si dhe shpenzimet e tjera të krijuara, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, ashtu që përmbartuesi dhe detyrimeve të bëhet përmes llogarisë së debitorit në Ministrinë e Financave - Departamenti i Thesarit dhe kalimin e mjeteve në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke deklaruar ndër të tjerash se fatura është pranuar dhe nënshkruar para dëmit të krijuar, andaj debitori i është përmbajtur me mirëbesim kushteve kontraktuese, përkundër që kreditori nuk i ka respektuar kushtet që rrjedhin nga kontrata bazë dhe e njëjta nuk i është përgjigjur thirrjeve të kreditorit për sanimin e problemit. Ka theksuar se edhe nga shkëmbimi i email-eve vërtetohet se dëmi është shkaktuar nga vetë debitori, duke neglizhuar tërësisht vendin dhe materialin montues - konstruksionin. Gjykatës i ka propozuar që të miratohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të përfundohet urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se fatura e bashkëngjitur në propozim përbën dokument të besueshëm, pasi që është në origjinal dhe është pranuar nga debitori dhe si e tillë është e ligjshme dhe e drejtë. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara të debitorit në prapësim nuk janë relevante në këtë procedurë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, si dhe të vazhdohet me urdhrin përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura me nr. 10431-210-001-20 e datës 10.12.2020, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit. Kjo për faktin që me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi që e njëjta nuk është protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit - Komuna e Klinës dhe nuk mbanë vulën e pranimit - protokollimit, nga rezulton se si e tillë e njëjta nuk është e përshtatshme për përbarim.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm edhe për faktin se në propozimin për përbarim nuk është përcaktuar fare afati i përmbushjes së detyrimit, siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se propozimi për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë *“kërkesën që organi përbarues ta detyrojë debitorin e përbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara”*.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.213/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.